

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. Shyqyri Brari, Ndërtesa 2, Dyqani 18,
Farkë, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050 ALL
NUIS: K91811014B

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
PLUS COMMUNICATION SH.A.

Sot, më datë 10 korrik 2020, në orën 15:00, nëpërmjet videokonferencës u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Plus Communication sh.a. me adresë në Tiranë, Farkë, Rruga Shyqyri Brari, Ndërtesa Nr. 2, Dyqani Nr. 18 (këtej e tutje "**Shoqëria**").

Janë të pranishëm:

1. **Alba – Trade Handels GmbH**, me seli ligjore në Schwarzenbegstraße 1-3, 1010 Vjenë (Austri), përfaqësuar nga përfaqësuesi me autorizim Znj. Blerina Nikolla, shtetase shqiptare, lindur më 4 maj 1987, në Fier, me vendbanim në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal I75504081J, në cilësinë e aksionarit zotërues i 31,83% të kapitalit të Shoqërisë;
2. **Union Grup Sh.a.**, me seli ligjore në Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Ismail Qemali, nr. 32, kati 3, 1019, Tiranë, NUIS K61527801R, përfaqësuar nga përfaqësuesi me autorizim Znj. Gentiana Gjermani, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 2 maj 1975, me vendbanim në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H55502046I, në cilësinë e aksionarit zotërues i 24,04% të kapitalit të Shoqërisë;
3. **Albanian Distribution & Development Sh.p.k.**, me seli ligjore në Rruga Dhaskal Tod'hri, nr. 35. Kashar, Tiranë, NUIS K21308001C, përfaqësuar nga administratori Z. Xhafer Xhako, lindur në Kolonjë, më 1 janar 1964, me vendbanim në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G40101215I, në cilësinë e aksionarit zotërues i 12,13% të kapitalit të Shoqërisë;
4. **Znj. Matilda Shehu**, shtetase shqiptare, lindur në Korçë, më 27 prill 1973, me vendbanim në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H35427169L, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,41% të kapitalit të Shoqërisë;
5. **Znj. Gentiana Gjermani**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 2 maj 1975, me vendbanim në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal H55502046I, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,01% të kapitalit të Shoqërisë;
6. **Znj. Orsiola Mekollari**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 13 mars 1986, me vendbanim në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal I65313063D, në cilësinë e aksionarit zotërues i 0,002% të kapitalit të Shoqërisë.

Lista e aksionarëve të pranishëm në Asambleshë e Përgjithshme i bashkëlidhet këtij procesverballi.

Me konsensusin e të pranishmëve, Znj. Matilda Shehu merr përsipër drejtimin e mbledhjes dhe Z. Enklid Milaj, që është gjithashtu i pranishëm dhe pranon, të kryejë funksionin e Sekretarit.

Kryetari, me ndihmën e Sekretarit, pasi verifikon identitetin dhe tagrat e të pranishmëve në lidhje me pjesëmarrjen në këtë Asamble, deklaron se Asambleja e Shoqërisë është mbledhur në përputhje me statutin e saj, në vijim të thirrjes datë 19 Qershor 2020 drejtuar aksionarëve të Shoqërisë për të diskutuar dhe vendosur mbi Rendin e Ditës si më poshtë vijon.

Rendi i ditës

1. **Aprovimi i Pasqyrave Financiare 2019 dhe destinacioni i rezultatit financiar;**
2. **Emërimi i shoqërisë së Auditimit për pasqyrat e vitit 2020;**



Selia Ligjore: Rr. Shyqyri Brari, Ndërtesa 2, Dyqani 18,
Farkë, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050 ALL
NUIS: K91811014B

3. Të tjera.

Pasi konstaton

praninë e aksionarëve që përfaqësojnë 68,422% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, të pranishëm personalisht ose nëpërmjet autorizimeve dhe prokurave të posaçme, Kryetari

deklaron

mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (këtëj e tutje "**Asambleja**") të rregullt dhe të aftë për të diskutuar e vendosur në mënyrë të vlefshme mbi Rendin e Ditës në përputhje me nenin 12 të Statutit të Shoqërisë.

1. Aprovimi i Pasqyrave Financiare 2019 dhe destinacioni i rezultatit financiar

Në lidhje me pikën e parë të Rendit të Ditës, merr fjalën Znj. Matilda Shehu, e cila paraqet rezultatet e pasqyrave financiare të Shoqërisë të mbyllura në 31 dhjetor 2019 dhe opinionin përkatës të shoqërisë së auditimit Grant Thornton Sh.p.k..

Znj. Shehu komenton detajet e të dhënave financiare për vitin ushtrimor 2019 dhe vë në dukje se, për këtë vit, Shoqëria regjistron një humbje prej 526.217.000 Lekë, ndërsa humbja e akumuluar është 2.342.484.000 Lekë.

Më tej, aksionarët shtrojnë pyetje të ndryshme në lidhje me zërat specifike të pasqyrave financiare të Shoqërisë dhe problemet e ndryshme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e saj.

Pas një diskutimi mbi pikën e mësipërme, Asambleja unanimisht

VENDOS

- (1) miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin ushtrimor 2019, të cilat regjistrojnë një humbje prej 526.217.000 Lekë si dhe një humbje të akumuluar prej 2.342.484.000 Lekë, të cilat do të mbarten në periudhat e ardhshme;
- (2) miratimin e raportit të Këshillit të Administrimit në lidhje me mbikqyrjen dhe administrimin e Shoqërisë gjatë vitit ushtrimor 2019;
- (3) miratimin e raportit të ecurisë së Shoqërisë për vitin ushtrimor 2019 hartuar nga Administratori i Shoqërisë.

2. Emërimi i shoqërisë së Auditimit për pasqyrat e vitit 2020

Kryetarja e Asamblesë, Znj. Matilda Shehu u sqaron të pranishmëve se është e domosdoshme që Asambleja të emërojë për vitin në vazhdim shoqërinë e auditimit për auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2020.

Propozohet emërimi i Grant Thornton Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Hyrja B, Kati 1 dhe NUIS K91923007M, si shoqëri e vetme auditimi për auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin ushtrimor 2020.

Pas ilustrimit të propozimit të mësipërm, Asambleja unanimisht

VENDOS



2

PLUS COMMUNICATION SH.A.

Selia Ligjore: Rr. Shyqyri Brari, Ndërtesa 2, Dyqani 18,
Farkë, Tiranë
Kapitali Themeltar: 266.430.050 ALL
NUIS: K91811014B

- (1) emërimin e shoqërisë Grant Thornton Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D, Hyrja B, Kati 1 dhe NUIS K91923007M, si shoqëri të vetme auditimi për auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin ushtrimor 2020.

3. Të tjera

Në lidhje me pikën e tretë dhe të fundit të Rendit të Ditës, Znj. Matilda Shehu vë në dukje se mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë përfundon më datë 19 korrik 2020. Duke qenë se është në interesin më të mirë të Shoqërisë, propozohet riemërimi si anëtarë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë i Z. Bukurosh Stafa, Z. Xhaferr Xhako dhe Z. Emurlai Nusret për një periudhë 1 (një) vjeçare. Pas diskutimit mbi propozimin e mësipërm, Asambleja unanimisht

VENDOS

- (1) të riemërojë, për një periudhë 1 (një) vjeçare, si anëtarë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë personat e mëposhtëm:
- (i) Z. Bukurosh Stafa, shtetas shqiptar, lindur më 26 korrik 1951, në Elbasan, me vendbanim në Rr. Brigada e VIII, në Tiranë, me pasaportë nr. BG3794299;
 - (ii) Z. Emurlai Nusret, shtetas austriak, lindur më 10.06.1971, në Tenovo (Maqedoni), me pasaportë nr. U0280609; dhe
 - (iii) Z. Xhaferr Xhako, shtetas shqiptar, lindur më 01.01.1964, në Kolonjë, me letërnjoftim me nr. personal G40101215l.

* * *

Meqë nuk ka çështje të tjera për tu diskutuar dhe meqë askush nuk e kërkoi fjalën, Kryetarja e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 17:00.

Dokumentet në vijim i bashkëlidhen këtij vendimi:

- Listë-prezenca e aksionarëve të pranishëm në Asamble;
- Autorizimet e aksionarëve të përfaqësuar në Asamble.


Kryetari/ Matilda Shehu




Sekretari/ Enklid Milaj